

Termet e Referencës

Ekspert/e për zhvillimin e analizës mbi perspektivën e aftësisë së kufizuar dhe perspektivës gjinore

HYRJE

HANDIKOS, “Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Kosovës” është krijuar si reagim ndaj gjendjes së vështirë në të cilën gjenden personat me aftësi të kufizuara në Kosovë, e themeluar nga dhe për personat me aftësi të kufizuara, me aktivitete të pandërprera që nga viti 1983. Si organizatë përfaqëson, përkrahë dhe punon për dhe me personat me aftësi të kufizuar përmes avokimit dhe lobimit. Ofron shërbime të ndryshme përmes rrjetit të shtrirë në gjithë Kosovën dhe promovon barabarësinë, jetën e pavarur dhe me dinjitet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

I. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

HANDIKOS në partneritet me Save the Children në Kosovë është duke implementuar projektin “Handikos for Child Rights-H4CR”, i cili financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim (SIDA). Përmes këtij projekti HANDIKOS synon ngritjen e kapaciteteve dhe fuqizimin e fëmijëve me Aftësi të Kufizuara.

II. OBJEKTIVA E DETYRËS

HANDIKOS është në kërkim të një eksperti/e për të zhvilluar një analizë gjithëpërfshirëse lidhur me perspektivën e aftësisë së kufizuar dhe asaj gjinore. Objektivi i kësaj analize është të sigurojë një pamje gjithëpërfshirëse që nxjerr në pah mundësitë dhe sfidat unike me të cilat përballen individët në raport me aftësinë së kufizuar dhe perspektivën gjinore. Eksperti/ja do të jetë përgjegjës për kryerjen e një analize të plotë që identifikon kornizat ligjore, politikat dhe rregulloret që kanë të bëjnë me barazinë gjinore dhe aftësinë e kufizuar, duke përfshirë edhe perspektivën e fëmijëve.

Specifikisht HANDIKOS pret nga eksperti që:

Të analizojë se si aftësia e kufizuar dhe gjinia kryqëzohen dhe ndikojnë në përvojat, të drejtat dhe mundësitë e individëve, duke identifikuar sfidat unike me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht duke u fokusuar në mënyrën se si këto sfida ndryshojnë midis gjinive.

Të rishikojë politikat, programet dhe praktikat ekzistuese në lidhje me aftësinë e kufizuar dhe barazinë gjinore, duke nxjerrë në pah boshllëqet, pikat e forta dhe fushat me nevojë për përmirësim, dhe duke ofruar rekomandime për qasje më gjithëpërfshirëse dhe efektive.

Të identifikojë barrierat sociale, ekonomike, kulturore dhe mjedisore me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara, me fokus të veçantë në barrierat specifike gjinore, duke bërë ekzaminim të detajuar të këtyre barrierave dhe të sugjerojë mënyra për tejkalimin e tyre.

Të mbledhë dhe analizojë të dhëna në lidhje me aftësinë e kufizuar dhe gjininë, duke siguruar që analiza të bazohet në burime të besueshme të të dhënave dhe të përdorë metodologji të përshtatshme për gjetje gjithëpërfshirëse dhe të sakta.

Të zhvillojë rekomandime të zbatueshme për HANDIKOS-in dhe palët e tjera të interesuara për të promovuar barazinë gjinore dhe të drejtat e aftësisë së kufizuar, duke dhënë rekomandime që janë specifike, të realizueshme dhe që synojnë politikëbërësit, organizatat dhe udhëheqësit e komunitetit.

III. KUALIFIKIMI

Kandidati duhet të posedoj këto aftësi dhe kompetenca:

- Diplomë/ kualifikim në shkencë sociale;
- Përvojë dhe njohuri të gjerë në fushat e barazisë gjinore dhe gjithëpërfshirjes sociale;
- Njohuri të dëshmuara në fushën e të drejtave të njeriut ose të drejtave të grave (Përvoja në punë në fushën e të drejtave të fëmijëve do të ishte vlerë e shtuar);
- Aftësi për të hartuar dokumente në një format të përshtatshëm për lexuesin, duke dëshmuar shkathtësi të shkëlqyeshme analitike.

IV. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Rishikimi/analizimi i Politikave, Strategjive dhe Planeve të Veprimit ekzistues të Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me aftësinë e kufizuar dhe perspektivën gjinore në 5 vitet e fundit.
- Realizimi dhe vlerësimi i shkallës së integritit të perspektivës së aftësisë së kufizuar dhe perspektivës gjinore në këto dokumente;
- Shqyrtimi i sfidave me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara nga këndvështrimi gjinor;
- Të analizohen ndërlidhjet midis rëndësisë gjinore dhe aftësisë së kufizuar në nivel politikash;
- Identifikimi i fushave që kërkojnë përmirësim për të promovuar të drejtat dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara (duke përfshirë arsimin, punësimin, kujdesin shëndetësor dhe shërbimet sociale);
- Identifikimi i raporteve, hulumtimeve dhe analizave tjera relevante që kanë në fokus integrimin gjinor në kuadër të sektorëve të ndryshëm që ndërlidhen me aftësinë e kufizuar;
- Rekomandime të hulumtuara mirë për vendimmarrësit, shoqërinë civile dhe partnerët ndërkombëtar për ta forcuar perspektivën e aftësisë së kufizuar dhe perspektivën gjinore.

V. ANGAZHIMI I ESKPERTIT/ES

Eksperti/ja do të angazhohet me anë të një kontrate për shërbim me HANDIKOS.

Ai/ajo do të angazhohet për 7 ditë në periudhën kohore prej 3 javë dhe pritët të dorëzojë: Një dokument që mbulon përgjegjësitë e përmendura në seksionin "Detyrat dhe Përgjegjësitë".

VI. KUSHTET E PAGESËS

Pagesa e ekspertit/es do të bëhet sipas ofertës përkatëse për kryerjen e shërbimeve, që do të lëshohet nga ai/ajo, pas finalizimit të dokumentit/analizës.

HANDIKOS do të realizoj pagesën në Euro, shuma bruto për ditët e punës (nga të cilat do të ndalet tatimi në fitim dhe kontributi pensional sipas ligjeve në fuqi në Kosovë).

HANDIKOS rezervon të drejtën e negociimit të propozimit financiar.

VII. PROCEDURA PËR APLIKIM

- Metodologji e punës për këtë angazhim ose shembuj të angazhimeve të mëparshme të natyrës së ngjashme;
- Curriculum Vitae (CV) (max.3 faqe);
- Propozimi financiar.

Aplikacionet duhet të dorëzohen në formë elektronike në e-mail adresën: handikos@handi-kos.org
cc: nora.simitciu@handi-kos.org

Ju lutem, shkruani në subjekt Aplikimi për: **Ekspert për zhvillimin e analizës mbi perspektivën gjinore dhe aftësinë e kufizuar**

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është 28/06/2024, ora 17:00.

Vetëm kandidatët e suksesshëm do të kontaktohen!

Pas përzgjedhjes Eksperti/ja i/e përzgjedhur duhet të dërgojë:

- **Dokumentin/ Dëshminë që nuk është nën hetime.**

Poashtu, ai/ajo duhet të nënshkruajë edhe:

- **Rregulloren mbi Parandalimin e Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual - Pshas**